



PreTone

Ngjyra të ndryshme

NGJYROSJE



Bojë me bazë uji për parkete dhe dysheme druri. Intensifikon ngjyrën nën vajrat ngjyuese. Duke theksuar strukturën e drurit arrihen efekte ngjyrash vibrante.

- Për ngjyra shumë të forta
- Redukton zverdhjen shkaktuar nga vajrat
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Pa tretës
- Mundësi kombinimesh të pafundme të ngjyrave
- Me aromë neutrale

Gama e përdorimit:


Mbi drurë të papërpunuar të lëmuar me kujdes. Përmes kombinimit të lagës dhe ngjyrosjes arrihen efekte ngjyuese intensive veçanërisht në nuanca të çelura. Në kombinim me LOBA 2K ImpactOil Color & LOBA 2K Intensive Color mund të arrihet një larmi nuancash ngjyuese. Mundësitë e këtyre kombinimeve të ngjyrave ju lejojnë zgjidhje të pafundme në çdo aplikim.

Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
10612	2,5l	6	144

Të gjitha ngjyrat disponohen në mostra 100 ml.

Solide	4,5 ±2%
Magazinimi dhe transportimi	36 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica. Material i parrezikshëm sipas ADR.
GISCODE	W1



I bardhë I zi Brown Mocha Steel

Pa garanci për ngjyrën

Udhëzime përpunimi

- Sipërfaqja duhet të jetë lëmuar siç duhet. Dyshemeja duhet të jetë e thatë, pa shtresa të vjetra, vaj, yndyra, dyll, silikon, pluhur lëmimi dhe papastërti të tjera.
- Kushtet optimale të përpunimit eksitojnë në një temperaturë mjedisi nga +15°C deri + 25°C, temperaturë dyshemeje +15°C deri +22°C, lagështirë relative të ajrit 40% - 65%, temperaturë të materialit +18°C - + 25°C, lagështirë maksimale të drurit 12%, ajrosini mjaftueshëm mjediset e punës.
- Për të parandaluar dëmtimet e parketit duhet që gjatë përpunimit të synohet klima e pritshme e mjedisit që pritet në mesin e vitit.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Tundni mirë materialin.
- Cilësitë e drurit të përdorur, struktura dhe poret, si dhe kualiteti i motivit lëmuar ndikojnë intensivisht në nuancën e ngjyrës që arrihet. Rekomandojmë patjetër krijimin e mostrës së ngjyrës mbi drurin origjinal - pasi është lëmuar me teknikën e përshtatshme, për të kontrolluar ju vetë rezultatin dhe nëse nevojitet për ta miratuar klienti pë të cilin punoni.
- Gjatë mbushjes dytësore, në përgjithësi nivelet jo të njëtrajtshme të bazamentit/dyshemesë së parketit dhe drurit intensifikohen. Për të pasur një pamje të njëtrajtshme është e nevojshme të bëhet një trajtim paraprak i kujdesshëm dhe homogjen.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në www.wingis-online.de.

HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

LOBA Pompë spërkatje dhe pastrues Wischwiesel ose LOBA Rulon Microfaser 100-120 si shtupë / përafër. 100-120ml/m² (8-10m²/l). Lëmimi i fibrave të drurit që mund të kenë dalë gjatë natës pas tharjes bëhet me aparat lëmuar me disk tek dhe LOBASAND SpecialPad të gjelbër.

KOHA E THARJES

- Tharje gjatë natës. Aplikim me vaj brenda 24 orëve.

PRODUKTE PËR IMPRENJIM TË MËPASSHËM:

- 2K Intensive Color
- 2K ImpactOil Color.

APLIKIM ME FSHIRJE

- Aplikoni njëtrajtësisht PreTone me shtupë rulon Microfaser 100-120.
- Në vijim njëtrajtësoni sipërfaqen në drejtim të fibrave të drurit me rulon 100-120, dhe nëse materiali është përthithur plotësisht nga druri, aplikoni material shtesë.
- Punoni në seksione.
- Tharje përgjatë natës.
- Lëmoni sipërfaqen me aparat me disk tek me LOBASAND SpecialPad jeshil (lëmimi i fibrave të ngritura të drurit) dhe në vijim largoni pluhurin e lëmimit.
- Brenda 24 orëve bëni imprenjimin e sipërfaqen me ngjyrën e dëshiruar LOBA 2K ImpactOilColor ose LOBA 2K IntensiveColor, Proçedoni sipas informacionit teknik të produktit.

APLIKIM ME SPËRKATJE

- Veçanërisht për sipërfaqe të mëdha aplikimi me spërkatje me LOBA spray ofron kursim të konsiderueshëm në kohë dhe mënyrë punimi ergonomik. Aplikimi me aparatit spërkatës duhet të kryhet nga dy veta dhe menjëherë pas spërkatjes duhet të bëhet njëtrajtësimi i sipërfaqes. Në sipërfaqe të lidhura midis tyre mbi 100m² duhet të përdoren dy ose më shumë aparate.
- Para fillimit të punës zona si p.sh. dyer, bazamente, etj. duhet të izoloohen me shirit ngjithës të përshtatshëm. Mbani majën e aparatit spërkatës mundësisht të qëndrueshme në një kënd dhe largësi konstante nga sipërfaqja, spërkatni PreTone në shirita afërsisht 100-120ml/m². Sapo të spërkatet një shirit, menjëherë njëtrajtësoni sipërfaqen me LOBA Wischwiesel.
 - Tharje për një natë.
 - Lëmoni sipërfaqen me aparat me disk tek me LOBASAND SpecialPad jeshil (lëmimi i fibrave të drurit që mund të kenë dalë gjatë tharjes) dhe në vazhdim largoni pluhurin e lëmimit.
 - Brenda 24 orëve bëni imprenjimin e sipërfaqes me ngjyrën e dëshiruar LOBA 2K ImpactOilColor ose LOBA 2K IntensiveColor. Proçedoni sipas informacioneve teknike të produktit.

Udhëzime të përgjithshme

Pastrimi i mjeteve të punës: Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

Koha e tharjes: Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBA Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Ngjitje e cepave: Parketet që nuk janë ngjitur në mënyrë të qëndrueshme, dyshemetë me dërrasa druri, dyshemetë me veshje druri, parketet industriale, parketet mbi dysheme me system ngrohje si edhe llojet e drurit me kohë të shkurtër ndryshimi të lagështirës (p.sh. ahu) shfaqin ndryshime dimensionale në varësi të luhatjes së klimës së ambientit (lagështia relative e ajrit, temperatura). Me aplikimin e vajit në anët ngjetëse nuk shfaqen plasaritje të fugave .

Ndërveprime: Materiale të tilla si p.sh. nënshtresat e tapeteve, këmbët dhe rrotat e mobiljeve, ngjitësat elastikë për ngjitje ose fiksime të parketeve mund të shkaktojnë zbutje dhe çngjyrosje. Materiale ndërtimi të lëna mbi lidhjet mund të ndikojnë negativisht në prekje dhe në pamje. Ekspozimi në bojra floku, goma makinash, motorash, biçikletash, gjithashtu mund të shkaktojë çngjyrosje të përhershme dhe të pandryshueshme të sipërfaqes.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speziale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjë ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.